




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

Nga Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur më 22.8.2011 me këtë:

R E N D P U N E

1. Ridestnimi i mjeteve në buxhet
2. Rritja e planifikimit të buxhetit nga të hyrat vetanake

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Të pranishëm në punimet e Seancës së jashtëzakonshme ishin:
Anëtarët e Kuvendit
Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa
Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesit e OSB-së
Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
Mediet

Seancën e jashtëzakonshme e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit i cili fillimisht e përshëndeti kryetarin e Komunës, z. Qemajl Mustafa, anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive, OJQ-të, mediet dhe të gjithë të pranishmit në sallë.

Në vazhdim të seancës kryesuesi kërkoi nga sekretari për ta verifikuar prezencën e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë.

U konstatua nga ana sekretarisë se në sallë janë të pranishëm 34 anëtarë të Kuvendit, kurse mungojnë 7 (Sabedin Kadriu, Enver Hajdrullahu, Shpresë Hajdari, Mimoze Kadriu, Tefik Ibrahim, Mimoze Shkodra-Bislami dhe Vjollcë Matoshi).

Pasi që kishte kuorum, kryesuesi kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se a pajtohen me këtë rend pune?

Sokol Haziri- siç e dini z. Kryesues para pak ditës në seancën e kaluar, opozita e ka braktis sallën, për shkak se ka qenë mënyra e parregullt e thirrjes së asaj seance. Ne si AAK

edhe për këtë seancë e kemi një konstatim se edhe KPF është thirr në mënyrë krejt parregullt dhe në atë seancë kanë marrë pjesë vetëm partia në pushtet dhe aleati i saj.

Unë kam dhënë pëlqimin që sot të qëndrojmë në sallë, por gjithsesi kërkojmë që të respektohen procedurat për thirrje të seancave (mbledhjeve) edhe të komiteteve dhe të Kuvendit.

Si do që të jetë unë në të ndryshme kam një çështje të cilës mjeshtërisht po i bishtnohet diskutimit rreth saj e kjo është që të rishqyrtohet paneli i intervistimit të praktikantëve në konkursin e Drejtorisë për Arsim, të rishqyrtohet nga ana e kryetarit, sepse ne nuk e kemi asnjë informacion lidhur me këtë çështje dhe në çfarë stadi është ky zhvillim, prandaj në pikën nën të ndryshme kërkoj që kjo të rishqyrtohet.

Zijadin Maliqi- lidhur me rendin e punës po theksoj se pika e parë e rendit të punës është plotësisht e arsyeshme e cila ka të bëjë me ridestinimin e mjeteve, mirëpo pika e dytë unë mendoj se është e panevojshme për të diskutuar rreth saj. Arsyeja është, sepse pika e dytë është një planifikim i buxhetit, kur dihet se planifikimi i buxhetit është bërë, rishikim nuk ka, nuk ka pasqyrë ende për të parë se sa është bërë realizim i mjeteve? Neve edhe në fillim nuk e kanë pranuar nga MEFI- mjete më tepër të planifikuara.

Unë edhe më parë e kam thënë se ato janë mjete të planifikuara dhe në momentin kur ato krijohen, KK- e ka të drejtën e destinimit të tyre. Këtë vendim do ta shqyrtojë edhe Drejtoria për Financa, po unë mendoj se nëse e dërgojmë këtë vendim në MEF, po dyshoj se mos po dalim qesharak dhe joserioz, sepse buxheti ende nuk është realizuar në atë masë që e kemi planifikuar. Kërkoj nga drejtori të na japin sqarime, sepse në atë aspektin profesional, unë mendoj se kjo është e panevojshme.

Izmi Zeka- para se të filloj seanca po kërkoj falje publikisht, sepse seancën e kaluar e kemi thirr një ditë përpara. Çështja e dytë se është thirr në marrëveshje me mua dhe kryetarin, prandaj e kuptoj se në një formë aspekti procedural është shkelur, prandaj për të gjitha këto së paku të keni një mirëkuptim.

Me këto pika jemi dakorduar dhe kemi biseduar me MEF-in të cilët kanë kërkuar për ta bërë një planifikim të buxhetit, sepse ne po llogarisim se do të kemi diku mbi 3.5 milion të hyra vetanake.

Sa i përket pikave të tjera e keni të qartë se në seanca të jashtëzakonshme nuk ka mundësi të hyjnë edhe pika të tjera.

Sokol Haziri- në adrsen elektronike përmes së cilës na ka ardh materiali, aty pashë se pos dy pika ve të cilave janë në rend të punës është edhe pika nën të ndryshme.

Izmi Zeka – është një lëshim (gabim) i sekretarisë!

Ju lus të deklaroheni se kush është për këtë rend të punës?

Aprovohet rendi punës me 18 vota për, 3 kundër të tjerët abstenojnë.

1. Ridestnimi i mjeteve në buxhet

Izmi Zeka- Kërkesat për ndryshim në buxhet duhet t' i bëjë drejtori i Financave dhe jo kryetari i Komunës. Ndryshimet i bënë drejtorja dhe i sjell këtu, prandaj kërkesa të tilla mos të sillen këtu, sepse nuk do t' i fusim në rend pune.

Kryesuesi i Kuvendit kërkon nga drejtori i Financave që ta jep një arsyetim lidhur me pikën e parë të rendit të punës.

Nuhi Nuhiu- është e vërtetë se nganjëherë duhet të koordinohen punët, por ligji mbi LVL më tepër i ka dhënë të drejtë kryetarit se sa drejtorëve, sepse ne jemi si këshilltarë të kryetarit. Do të kemi kujdes herëve të tjera që raportet t' i kenë me kohë këshilltarët për të parë pse po veprohet dhe punohet në këtë formë?

Në vijim të fjalës së tij z. Nuhiu i dha sqarimet në detale, të cilat të dhëna anëtarët e Kuvendit i kanë në materialin e seancës.

Jakup Bajrami- ne në takimin e që e patëm me shefat e grupeve, jemi pajtuar që këto dy pika të hyjnë në rend të punës për këtë seancë. Pika e parë është e obliguar, sepse duhet hapur rrugë dhe ecur përpara. Mirëpo sa i përket pikës së dytë nga vërejtjet që i dha Zijadini, por edhe nga arsyet që i dha drejtori, mendoj se mos po hyjmë në obligime të parakohshme nëse marrim një vendim të tillë, por edhe kjo nuk qenka edhe obligative, por vetëm për të hapur rrugët që mjetet të cilat i kemi t' i shpenzojmë dhe mos të presim ndonjë vendim tjetër të KK-së. Mirëpo nëse i shkelim procedurat, unë kisha thënë që pika e dytë mos të shqyrtohet as aprovohet, kurse të parës t' i epet viza. Ne nuk duhet t' i shkelim obligimet dhe detyrat tona dhe mos të merremi me diçka që nesër duhet rikthyer prapa dhe të bëhet një debat i panevojshëm.

Ziadin Maliqi- kryesisht e tha edhe Jakupi, por unë edhe më parë i thash vërejtjet tek pika e dytë, sepse tash u bashkuan këto dy pika. Pika e parë është e arsyeshme, sepse duhet të bëhet ridestnimi i mjeteve që teprojnë, apo mungojnë të cilat duhet plotësuar.

Te pika e dytë po bëjmë diçka që nuk e kemi me ligj, sepse unë e dëgjova drejtorin se po na duhen edhe 1 milion euro për t' u realizuar buxheti të cilin e kemi planifikuar në fillim.

Është e vërtetë se korriku ka qenë i mirë, por ky muaj gjithmonë është i tillë, por më vonë ka mundësi që mos të realizohen mjete. Unë kërkoja që kjo pikë të hiqet, sepse ku është ajo e mirë që ne të realizojmë mjete tepër për të cilat shumë lehtë mund ta bëjmë destinimin e tyre .

Mirëpo nëse hyjmë në destinim si janë planifikuar edhe aty i kam disa vërejtje, sepse mjetet kryesisht janë destinuar mjetet për mallra dhe shërbime për të cilat kur është planifikuar buxheti unë kam dhënë vërejtje se aty kemi mjete të tepërta të planifikuara.

Mirëpo përsëri pjesa dermuese e tyre janë të planifikuara për mallra dhe shërbime dhe më tepër më pengon ajo për mjetet e tatimit në pronë, taksat për pajime motorike, lejet e ndërtimit e të cilat janë mjete të destinuara për qëllimin e vet dhe jo për mallra dhe shërbime. Unë vërejtjen më të madhe e kam që mjetet për pa i pasur mos t' i ndajmë, sepse nuk i kemi njëherë, kur t' i realizojmë i ndajmë pa asnjë problem.

Nuhi Nuhiu- lëvizje të buxhetit kemi nga muaji në muaj, janari i këtij viti ka qenë i realizuar 95% nga planifikimi që është 250 mijë euro mujor. Shkurti 71%, kurse marsi 120%, prilli

5% ka tejkalim, maji 16%, qershori 164%, ose 64% mbi planin, në përgjithësi në këtë muaj i kemi inkasuar mbi 411 euro, i cili inkasim nuk ka ndodhur asnjëherë prej kur ekziston qeveria komunale e pasluftës. Gjithashtu edhe korriku ka mjaft të hyra vetanake, mbi 345 mijë euro ose në përqindje 385 mijë euro tejkalim.

Duke u bazuar në shtatë muajt e kaluar shihet sa ka tejkalim 20% dhe në bazë të kësaj mendojmë se në muajt e ardhshëm do të kemi një tejkalim të tillë prej 20% dhe në bazë të kësaj planifikojmë që t' i ' inkasojmë 600 mijë euro të hyra vetanake. Unë po e them se kjo është ngarkesë për neve, por jam i bindur se 90% realizohet (i kësaj që po e planifikojmë). Ne po ngutemi, sepse investimet kapitale më 9 nëntor mbyllen, nuk kemi alokime të mjetëve, nuk kemi shpenzime. Tash jemi në gusht dhe po hyjmë në shtator dhe është periudha ku buxheti shpenzohet më pak, por ne kemi edhe të planifikuar edhe shpenzimin mujor, prandaj duhet t' i përmbahemi atij plani.

Mendoj se nuk është mirë që të këmbëngulim për mos ta rrit këtë planifikim. Opozita duhet ta pranojë këtë dhe të na jap vërejtje në fund, sepse përmdryshe nuk ka vend për kritikë.

Ilmi Limani- është e vërtetë se në kuadër të 3 milion e 600 mijë eurove, ne nuk do ta shkelim ligjin dhe të hyrat nga tatimi në pronë nuk do t' i japim për mallra dhe shërbime, por do t' i alokojmë te investimet kapitale. Sa i përket mjetëve motorike të cilat u përmendën, këto mjete do të përdoren për mirëmbajtjen verore të rrugëve.

Ramiz Ramadani- kur foli drejtori mu duken disa shpjegime bukur periferike, por edhe vërejtjet të cilat i dha z. Zijadini e di se drejtori i kupton shumë mirë, por edhe përgjigjet që i dha drejtori m' u duken anësore dhe jo të rëndësishme. Nga 600 mijë euro aq sa po planifikohet të bëhet ngritja, diku afër 350 mijë euro dedikohen për mallra dhe shërbime dhe mendoj se për secilën kategori duhet dhënë sqarime. Këtu i kemi vetëm 150 mijë euro investime kapitale, 100 mijë euro shpronësime, kurse të tjerat mallra dhe shërbime.

Pyetja e dytë është që buxheti i planifikuar për 2011 është i planifikuar 3.5 milion euro, por me këtë ngritje del diku mbi 4 milion e 100 mijë euro.

Sadudin Berisha- mendoj se Drejtoria e Buxhetit nuk ka nevojë shumë të manovroj se në këtë drejtori janë zyrtar së paku me një shkollë të mesme dhe ka kompozitet në shpjegimin e pikës së dytë. Ne para vetit e kemi një dokument i cili është i përjashtuar niveli i rrëzimit të buxhetit të planifikuar dhe të miratuar për vitin 2011. Kemi të bëjmë me shtim të buxhetit planifikim dhe riplanifikim të buxhetit të vitit 2011, nga të hyrat në shtyllën e parë nga tatimit në pronë, licencat e ndryshme dhe lejet për ndërtim të cilat janë gjithsejtë 5 milion e 700 mijë, kurse të paplanifikuara janë të paparashikuara prej burimeve nga i cili mund të realizohen janë vetëm 30 mijë euro. Nga kjo nënkuptohet se 570 mijë euro janë të planifikuara si shtesë në buxhetin e vitit 2011, të cilat 100% duhet të destinohen për nevojat e qytetarëve. Mirëpo pjesa tjetër e cila u tha shpenzimet nga mjetet e planifikuara prej 600 mijë eurove dhe që ka të bëjë vetëm 600 mijë është përjashtuar 3 milionëshi, ne po vlerësojmë se 3 milionëshi 100% po realizohet dhe nga ky fakt ne po planifikojmë të hyra shtesë edhe 600 mijë euro. Nga shpenzimet janë 600 mijë eurove, 300 mijë janë mallra dhe shërbime, shtylla e parë 200 mijë dhe shtylla e fundit 300 mijë. Mendoj se nuk ka nevojë të krijojmë kamuflime dhe mjegulli, por duhet të jepen shpjegimet dhe arsyetimet ashtu siç kërkohet dhe si e kërkon ligji. Pikërisht kjo ishte arsyeja kur u tha se nuk ka nevojë fare të futet në rend të punës, sepse nëse realizohet buxheti 120%, atëherë ato mjete të cilat

realizohen do t' i destinohen qëllimit për çka edhe janë planifikuar. Kështu që pika e dytë absolutisht nuk ka nevojë fare të diskutohet. Shpjegimet që u dhanë nuk janë të mira së paku për njerëzit të cilët thirren si ekspertë të fushës ekonomike, e më pak t' iu bëhet kamuflim anëtarëve të KK-së.

Nuhi Nuhiu- atë që e tha Ramiz Ramadani se planifikim ka qenë për 3 milion dhe jo 3.5, sepse ne kemi desh që t' i rrisim të hyra për 500 mijë eurove, por korniza afatmesme buxhetore dhe planifikimi i buxhetit, nuk na kanë lejuar një mundësi të tillë, por ne e kemi ditur se e kemi një kapacitet për ngritje të buxheti në 3.5 milion.

Sa i përket investimeve kapitale i kemi 350 mijë euro prej këtyre të hyrave, në participim të projekteve 150 mijë, eksproprijimi 100 mijë, kurse të shërbimet publike e kemi mirëmbajtjen dimërore të rrugëve. Këto janë 350 mijë për investime kapitale, kurse 250 mijë mbetën për mallra dhe shërbime dhe shpenzime të tjera. Z. Sadudini po thotë konfuz, por unë mund të flas tërë ditën këtu, por dikush mund të kuptoj dhe këtu nuk jemi të gjithë ekspertë, por ai ndoshta e quan veten ekspert si jurist, por për çështje ekonomike jemi më kompetent. Nëse unë nuk di ta them gjuhësisht mirë, në ekonomi janë shifrat dhe numrat mund t' i lexoni.

Unë nuk dua të komunikoj në këtë formë, por ju jeni këshilltarë, mendoni mirë këto gjëra, sepse nuk është mirë të na mbesin 400 mijë euro për pa u përdorur, mendoni vet a dëshironi për t' i shpenzuar apo jo? Mirëpo si ngarkesë i bie Drejtorisë së Financave për ta realizuar dhe shpenzuar këtë buxhet.

Sadudin Berisha- unë jo rastësisht e thash mos krijoni konfuzitet të këshilltarët komunal, sepse ju e dini më mirë se unë. Mirëpo kemi një shpërputhje të të hyrave jo numerike në objektiva. Kemi objektivin e të hyrave në katër shtylla dhe nga secili burim parashihet një masë e mjeteve të parashikuara dhe të shpenzimet. Shpenzimet nuk i dedikohen 100% të hyrave të planifikuara, nevojave të qytetarëve infrastrukturës nga burimet të cilat mendohen të realizohen në shtyllën e parë. Sikur shpenzimet të ishin dedikuar për infrastrukturë dhe nevojave të drejtpërdrejt të qytetarëve ky debat sigurisht nuk do të ishte bërë.

Zijadin Maliqi- ne si opozitë jemi i interesuar që këto të hyra të rriten, sepse këto të hyra shkojnë në shërbim të qytetarëve tanë, nuk i shkojnë ministrisë, por ato janë mjete të Komunës. Duhet ta hiqni prej mendjes se opozita është kundër, por këto të hyra nuk janë realizuar ende, prandaj shumica e dimë se kjo nuk është në rregull, sepse planifikimi nuk bëhet për muaj, por ai bëhet për vit. Ne i kemi planifikuar 3.5 milion, por ministria i ka pranuar si të planifikuara 3 milion të cilat nuk janë planifikuar për çdo muaj sa do të ketë mjete të realizuara, por janë të planifikuara për tërë vitin ato 3 milion.

Ato mjete të cilat realizohen mbi tre milion, ato i ndihmojnë shumë Komunës sonë dhe ato mjete mund t' i destinojmë sipas nevojave tona.

Edhe njëherë po e them se destinimi i mjeteve bëhet për ato mbi 3 milion euro.

Izmi Zeka- siç po shihet këtë çështje të gjithë e keni të qartë dhe nëse bëhet planifikimi edhe më herët së paku opinionet janë se ka rritje. Do të thotë do të rritet ai start dhe nëse ne e bëjmë alokimin deri në 3.5 milion, ne nuk bëjmë pengesë, por e obligojmë qeverinë komunale për të pasur një efikasitet më të madh.

Këtu nuk ka asgjë të keqe nuk po marrim ndonjë vendim që po dëmton interesin e dikujt, por po planifikojmë më shumë mjete në mënyrë që ato mjete mos të vijnë përsëri në Kuvend

ose mos të bllokohen. Unë mendoj se këtë përcaktim duhet ta kalojmë dhe përgjegjësia nga ky çast kalon në Qeverinë Komunale .

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi propozon që të aprovohet pika e parë e rendit të punës; Ridestnimi i mjeteve në buxhet

Aprovohet pika e parë e rendit të ditës: Ridestnimi i mjeteve në buxhet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovojnë edhe pikën e dytë të rendit të punës: Rritja e planifikimit të buxhetit nga të hyrat vetanake

Aprovohet pika e dytë e rendit të punës: Rritja e planifikimit të buxhetit nga të hyrat vetanake me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 16 ishin kundër.

Me aprovim të këtyre dy pikave të rendit të punës seanca i përfundoi punimet

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA